

## Raporti i Auditit Ligjor

(Për Pasqyrat Financiare të O.J.F., Klubi i Futbollit "Skenderbeu", për ushtrimin e mbyllur me datë 31.12.2018)

Drejtuar : Klubi i Futbollit "Skenderbeu"

Presidentit, Zt. Ardian TAKAJ,

Administratorit, Zt. Ilirjan PERMETI,

**Bashkia Korce**

Kryetarit, Zt. Sotiraq FILO

**Te nderuar,**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të O.J.F, Klubi i Futbollit "Skenderbeu", që janë bashkëngjitur këtij raporti, të cilat përfshijnë; Pasqyren pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta, pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

### Opinion

Sipas opinionit tonë, përvec efektit të cështjes së përshkruara në paragrafin e Bazës për një opinion me rezervë, pasqyrat financiare të mbyllura më datë 31 Dhjetor 2018, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të O.J.F., Klubi i Futbollit "Skenderbeu", si dhe të performancës së saj financiare, të rrjedhjes së parasë, për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar, dhe Ligjin Nr. 9228 datë, 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" (i ndryshuar).

### Baza për Opinionin me rezervë

Të drejtat dhe detyrimet me palët e tjera, të cilat përfaqësojnë vlera materiale në pasqyrat financiare, paraqiten për një periudhe relativisht të gjatë në kohë në pozicionet e tyre, dhe për to nuk është kosideruar krijimi i provizioneve. Ne nuk ishim në gjendje të perlllogarisnim efektet që mund të krijoheshin në pasqyrat financiare nga konsiderimi i krijimit të provizioneve.

Ne realizuam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësia jone, sipas këtyre standardeve është përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi te pavarur nga O.J.F., në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Une besoj se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### **Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brëndëshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimesi. Duke dhene informacion, nese është e zbatueshme, për ceshtjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabel të vijimësisë, përvec se në rastin kur drejtimi synon ta likuideojë shoqërinë ose ta ndërpresë veprimtarinë. Ata që janë ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjes për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të shoqërisë.

### **Përgjegjësia e Auditorit**

Përgjegjësia jone është, që bazuar në auditimin tonë të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombetare të Auditimit. Këto Standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojme siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, me qëllim që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin, gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Albion NDINI  
Auditues Ligjor



**Albion NDINI**  
Auditues Ligjor, Lic. 367

Tiranë, më 29.03.2019